



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË BURIMEVE  
NJERËZORE

RELACION

PËR

“DHËNIEN ME HUAPËRDORJE TË SIPËRFAQËS 300 M2, PJESË E PASURISË 8/145,  
VOL. 21 FAQE 130, ZK 8562, E LLOJIT TRUALL”

Bazuar në VKM nr. 1532 datë datë 19.11.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Korçë të Qarkut të Korçës” Bashkisë Korçë i janë transferuar një listë pronash të paluajtshme në pronësi ose në përdorim.

Bazuar në VKM-në e sipërcituar, trojet e lira, të pazëna janë transferuar vetëm në përdorim të Bashkisë Korçë.

Një nga këto pasuri është edhe prona objekt i këtij relacioni, pjesë e pasurisë Nr. 8/145, vol 21 faqe 130 ZK 8562 e llojit truall me sipërfaqe të përgjithshme 3992.35 m2, me pronësi shtet dhe me vendodhje në Kodrat e Qytetit, pasuri e identifikuar në hartën bashkangjitur këtij relacioni.

Me shkresë, protokolluar në Bashkinë Korçë Nr. 1136 Prot dt. 08.02.2024 Fondacioni Kenedi i është drejtuar Bashkisë Korçë, me kërkesë për marrjen në përdorim të 300 m2 truall, pjesë e pasurisë nr. 8/145 me kontratë huapërdorje për një afat 5 vjeçar. Qëllimi i marrjes në përdorim të kësaj sipërfaqe me huapërdorje është ndërtimi i një sere që të përdoret për ti ardhur në ndihmë komunitetit, qendrës rezidenciale për të moshuar, qendrës ditore të fëmijëve të braktisur, qendrës rezidenciale të vajzave si dhe projektit të shpërndarjes të ushqimit të ngrohtë për fëmijët në nevojë.

Sa më lart, bazuar në nenin 9 pika 12 gërmat a) "Njësitë e qeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e tyre të paluajtshme sipas mënyrës së përcaktuar në ligj dhe c) "E drejta e pronësisë ushtrohet nga këshilli përkatës" dhe pika 1.6 gërma a) "E drejta e lidhjes së kontratës" si dhe gërma e) e nenit 54 "Këshilli i Bashkisë miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve" të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr. 8744 dt 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit njësisive të qeverisjes vendore", Ligjit nr. 8743 dt 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit" i ndryshuar si dhe bazuar në nenet 901-912 të Kodit Civil, i propozojmë Këshillit Bashkiak Korçë të miratojë dhënien në përdorim, me kontratë huapërdorje Fondacionit Kenedi, të sipërfaqës prej 300 m2 pjesë e pasurisë Nr. 8/145, vol 21 faqe 130 ZK 8562 e llojit truall, me pronësi shtet dhe me vendodhje në Kodrat e Qytetit, me një afat 5 vjeçar.

Bashkangjitur këtij relacioni:

- Plani i rilevimit për punime kadastrale.

Drejtoreshë e Përgjithshme: A. Qeramixhi (Dishnica)

KRYETAR I BASHKISË

Sotiraq Filo



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË  
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

P/VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_.02.2024

PËR

“DHËNIEN ME HUAPËRDORJE TË SIPËRFAQËS 300 M2, PJESË E PASURISË 8/145,  
VOL. 21 FAQE 130, ZK 8562, E LLOJIT TRUALL”

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, bazuar në nenin 9 pika 1.2 gërmat a) dhe c); në nenin 54 pika 1.6 gërma a) dhe gërma e/1) të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 8744 dt 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit njësisive të qeverisjes vendore”, Ligjit nr. 8743 dt 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” i ndryshuar, në nenet 901-912 të Kodit Civil, dhe VKM Nr.1532 datë 19.11.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shterore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Korçë të Qarkut të Korçës”, e ndryshuar dhe pas diskutimeve të këshilltarëve:

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënien me huapërdorje Fondacionit Kenedi, të sipërfaqes prej 300 m2, pjesë e pasurisë Nr. 8/145, vol 21 faqe 130, ZK 8562 e llojit truall, me pronësi shtet dhe me vendodhje në Kodrat e Qytetit, pasuri e identifikuar në hartën bashkangjitur këtij relacioni.
2. Afati i dhënies me huapërdorje të jetë 5 vjeçar.

3. Qëllimi i dhënies me huapërdorje është ndërtimi i një sere që të përdoret për ti ardhur në ndihmë komunitetit, qendrës rezidenciale për të moshuar, qendrës ditore të fëmijëve të braktisur, qendrës rezidenciale të vajzave si dhe projektit të shpërndarjes të ushqimit të ngrohtë për fëmijët në nevojë.

4. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Korçë për lidhjen e kontratës së huapërdorjes.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike Menaxhimit të Burimeve Njerzore.

6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

Sekretari i Këshillit Bashkiak  
Eva NAÇI

**KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK**

**ANA VERUSHI**

Miratuar me \_\_\_\_\_vota  
Vota Pro \_\_\_\_\_  
Vota Kundër \_\_\_\_\_  
Vota Abstenim \_\_\_\_\_  
Zbardhur më datë \_\_\_\_\_

# PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI :SHTET

DATE 26/12/2023

QELIMI: QIRA MARRJE

VENDNDODHJA

BASHKIA KORCE

DVASHK/ZVASHK KORCE

ZONA KADASTRALE: 8562

NUMRI PASURISE: 8/145/1

INDEKSI I HARTES: KO-M-12

TE DHENAT E PASURISE

LLOJI PASURISE: TRUALL

SIP.PASURISE= 300 m2

SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT=0 m2


NUMRI KATEVE = 0

NUMRI PEMEVE = 0

X 567179  
Y 4498495.0

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X 567372.6  
Y 4498495.0



## SHPJEGUES

KUFIRI SIPAS DOKUMENTIT LIGJOR



SIPERFAQE =3992.35 m2

KUFIRI SIPAS KERKESES SE QIRASE



SIPERFAQE = 300.0 m2

X 567179  
Y 4498367.7

SH 1:1000

X 567372.6  
Y 4498367.7

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	VERI		NR PASURIE	8/145		
2	LINDJE		NR PASURIE	8/145		
3	JUG		NR PASURIE	8/145		
4	PERENDIM		NR PASURIE	8/145		

## REALIZOI PER BASHKINE KORCE

EMRI: Arber GREMI

LICENCA: NR.T.1562; DATE 6/5/2022

Arber  
Gremi

Digitally signed by  
Arber Gremi  
Date: 2023.12.26  
10:44:15 +02'00'

## TEKNOLOGJIA E MATJEVE: Z-G

Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;

PERCAKTIMI KUFIRIT: P; HK

Kode per percaktimin e kufirit:P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;

## SHENIME TE VECANTA:

## PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET

EMRI: \_\_\_\_\_

NENSHKRIMI \_\_\_\_\_

NENSHKRIMI/VULA \_\_\_\_\_

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale

Date 08/02/2024

*"Edhe në mëdajtë e nëntë herë po të  
rrëzohemi, përsëri duhet të ngrihemi"*

*Petro Nini Luarasi*



## Kerkesë

Drejtuar: Bashkisë Korçë

Kryetarit të Bashkisë

Z. Sotiraq Filo

BASHKIA KORÇE

NR /136/PROT  
DATA 08/02/2024

**Lenda: Kërkesë për marje në përdorim truall me kontratë huapërdorje.**

Fondacioni Kennedy me Seli në qytetin e Korçes, me adresë rruga "Niko Dodona" nr 6 lagjia 12 dhe me NIPT K64724001M, regjistruar me vendim të gjykatës së shkallës së parë të rrethit gjyqësor Tiranë nr 224 datë 19/06/2006 me drejtor ekzekutiv shtetasen Miranda Kalemi:

Kërkojmë nga bashkia Korçë të marrim në përdorim me kontratë huapërdorje një sipërfaqe toke truall sipas skicës bashkelidhur me numer pasurie 8/145 regjistruar në Vol :21, Fq:130 ZK.8562 me Sip 300 m<sup>2</sup> për një periudhë 5-vjecare, me adresë Kodrat e Qytetit (Kodra Kenedi).

Qëlimi kryesor i kësaj iniciative është që të mund të ndërtojmë një serrë që do të përdoret për të ardhur në ndihmë komunitetit, qendrës rezidenciale për të moshuar, qendrës ditore të fëmijëve të rrugës, qendrës rezidenciale të vajzave, si dhe projektit të shpërndarjes të ushqimit të ngrohtë për familjet në nevojë.

Ju faleminderit për mirkuptimin.

Per Fondacionin Kennedy

Drejtori Ekzekutiv

Miranda Kalemi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS  
DREJTORIA VENDORE KORÇË

Korçë, më \_\_. \_\_. 2023

Lënda : Kthim përgjigje.

Drejtuar : SHOQËRISË "KENNEDY" SHPK

Në përgjigje të kërkesës tuaj me nr. 23735, datë 05.12.2023, ku keni aplikuar shërbimin kerkese per informacion, ju bejmë me dije se:

Nga verifikimi në sistemin multifunksional të kërimit të pasurive rezulton se:

1. Pasuria me Nr. 8/145, regjistruar në Vol: 21, Fq:130, ZK. 8562, e llojit "Truall" me Sip. 3992.35 m2, rezulton e afishuar ne pronesi Shtet.

Ju faleminderit per mirëkuptimin!

DREJTOR

STAVRI MUSHKA

Ervin  
Feta

Digitally signed by:  
Ervin Feta  
Date: 2023.12.11  
02:14:53 +02'00'

Stavri  
Mushka

Digitally signed by:  
Stavri Mushka  
Date: 2023.12.11  
04:33:59 +02'00'






Image © 2026 Airbus